



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

PROJEKTRREGULLORJA
PËR
ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT,
VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Kaçanik , Tetor 2011

Në mbështetje të nenit 11, 12 dhe 34 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale , Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/08 për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Komunës me fshatrat ,Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, si dhe Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e vetë të mbajtur më _____, miraton

R R E G U L L O R E N

PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore, përcakton rregullat dhe procedurat për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e saj si dhe themelimin, kompetencat dhe përgjegjësit e këshillave lokale.

Neni 2 Fushëveprimi

Disapozitat e kësaj rregullore zbatohen në tërë territorin e Komunës së Kaçanikut.

Neni 3 Themelimi i këshillave lokale

- 3.1. Në Komunën e Kaçanikut, vetëqeverisja lokale ushtrohet, në qytet si këshilla urbane dhe në fshatra-vendbanime si këshilla të fshatrave.
- 3.2. Këshillat lokale themelohen për të siguruar një bashkëpunim më të ngushtë të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane për përmbushjen e nevojave të gjithë qytetarëve të komunës .
- 3.3. Territori (sipërfaqja) për të cilën themelohet këshilli urban, janë kufijtë e zonës kadastrave të qytetit sipas planit urbanistik, ndërsa këshillat e fshatrave mbulojnë territorin brenda kufijve të fshatrave, sipas kadastrës së vendbanimeve,dhe gjendjes faktike të krijimit të vendbanimeve.
- 3.4. Në rast se këshilli zgjidhet për më shumë fshatra, vendbanime apo lagje urbane, atëherë përbërja e këshillit duhet të reflektojë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagje urbane, me përfaqësim gjinor dhe etnik

Neni 4

Përbërja dhe zgjedhja e këshillave lokale

- 4.1. Këshilli i bashkësisë urbane në qytet, përbëhet prej **(9-11)** anëtarëve, kurse Këshillat në fshatra, vendbanime përbëhen prej **(5-7)** anëtarëve, varesisht nga numëri i banoreve dhe lagjeve.
- 4.2. Përbërja e këshillave urbane në qytet dhe në fshat, duhet të reflektojë edhe përfaqësimin gjinor.
- 4.3. Në rastet kur në një bashkësi urbane, fshat, vendbanim, jetojnë anëtarë të pakicave, ata duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin, me së paku një (1) anëtar.
- 4.4. Këshilli zgjedhet përmes tubimeve të qytetarëve të atyre bashkësive urbane, fshatrave, vendbanimeve përmes votimit të fshehtë ose të hapur.
- 4.5. Tubimin publik deri në zgjedhjen e këshillit lokal e kryeson qytetari më i vjetër i cili merr pjesë në tubim.
- 4.6. Këshilli zgjidhet me mandat për (4) katër vite. Nga radhët e anëtarëve të tij, zgjedhet kryetari me mandat për katër (4) vite. Deri në zgjedhjen e kryetarit të këshillit, me Këshillin udhëheq anëtari më i vjetër i këshillit.
- 4.7. Për kryetar të këshillit, zgjidhet kandidati i cili ka fituar shumicën e votave, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të bashkësisë urbane, fshatit, vendbanimit, pjesmarrës në tubimin zgjedhor. Nëse në rrethin e parë asnjë nga kandidatët për kryetar të këshillit nuk ka fituar numrin e duhur të votave, organizohet rrethi i dytë i votimit për dy kandidatët të cilët kanë fituar numër më të madh të votave. Në rrethin e dytë kryetar zgjedhet kandidati i cili fiton më shumë vota.
- 4.8. Kryetari i këshillit thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit, gjithashtu thërret dhe udhëheqë tubimet me qytetarë. Kryetari i nënshkruan aktet e miratuara nga ana e këshillit dhe është i obliguar në afat prej 7 ditëve, nga dita e miratimit të tyre, t'i dërgojë në Komunë për publikimin e tyre në gazetën zyrtare ose ueb faqen e Komunës.
- 4.9. Këshilli, anëtarët dhe kryetari i këshillit mund të shkarkohen edhe para kalimit të mandatit, nëse nga zgjedhësit e tyre konstatohet se kanë lëshime në punët e tyre .
- 4.10. Shkarkimi i këshillit, anëtarëve dhe kryetarit të këshillit, bëhet sipas procedurës së njëjtë për zgjedhjen e këshillit dhe të kryetarit.

Format e shkarkimit:

- Me vdekjen e tij,
- Me dorëheqjen e tij,
- Me shkarkim.

Neni 5

Numri i Këshillave

Numri i Këshillave urbane në qytet dhe në fshatra, si dhe përbërja e tyre përcaktohet me këtë rregullore dhe do të paraqiten në shtojcën I e cila do të jetë pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Mbështetja e themelimit të Këshillave

Implementimin e kësaj rregullore, dhe mbështetjen për formimin e këshillit urban të qytetit dhe këshillave të fshatrave do ta bëjë ekzekutivi i Komunës, përkatësisht Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.

Neni 7

Informimi për mbajtjen e tubimeve të qytetarëve

7.1. Një javë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave, Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës për informim, informon qytetarët përmes:

- a). shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- b). mediave të shkruara dhe elektronike lokale dhe
- c). web – faqes zyrtare të Komunës.

7.2. Njoftimi i publikut sipas paragrafit 7.1 të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajné:

- a) datën e tubimit të qytetarëve;
- b) kohën e tubimit të qytetarëve;
- c) vendin e mbajtjes së tubimit të qytetarëve dhe
- d) rendin e ditës.

Neni 8

Përmbajtja e procesverbalit

8.1. Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përmbaj: numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen e këshillit lokal, procedurat e votimit dhe çështje tjera të nevojshme, që duhet të shënohen në procesverbal.

8.2. Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit dhe procesmbajtësi, ndërsa Drejtoria e Administratës, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve për zgjedhjen e këshillave urbane, dhe fshatrave.

Neni 9

Kompetencat dhe përgjegjësite e Këshillit

9.1. Këshillat e fshatrave, ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:

- a) hartojnë dhe miratojnë rregulloren e punës së këshillit;
- b) organizojnë, përcjellin dhe planifikojnë zhvillimet e lokalitetit, në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Komitetet, Kryetarin e Komunës dhe drejtoritë e Administratës Komunale;
- c) emërojnë komisionet përkatëse për t'i realizuar objektivat e lagjeve urbane dhe lokaliteteve në fshatra;
- d) hartojnë planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat
- e) ndërmarrin iniciativa për ruajtjen e pronës së Komunës dhe pasurive tjera të paluajtshme shtetërore në lokalitetin përkatës ;
- f) përgatisin raportin 6 mujor dhe vjetor të mjeteve të arkëtuara dhe i bëjnë ato transparente për qytetarët e lokalitetit, në harmoni me dispozitat e Statutit të Komunës dhe të kësaj Rregulloreje;
- g) sigurojnë të dhëna elementare për secilën familje të lokalitetit përkatës, përcjellin gjendjen ekonomike të tyre dhe japin rekomandime e propozime në lidhje me këto;
- h) kujdesen për furnizim me ujë, rregullimin e kanalizimit, drenazhimet dhe ofrimin e shërbimeve publike efikase në lokalitetet e tyre etj;
- i) kujdesen që qytetarëve t'ju ofrohet mbrojtja shëndetësore primare;
- j) kujdesen për mbrojtjen e ambientit dhe zhvillimin e turizmit të lokalitetit ;
- k) kujdesen për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
- l) bashkëpunon me organet e Komunës dhe organizatat tjera për çështjet me interes për lokalitetin;
- m) evidentojnë dhe paraqesin prioritetet e lokalitetit para organeve të Komunës;
- n) kujdeset për organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin ;
- o) në bazë të nevojave dhe kërkesës së qytetarëve apo me iniciativën e Këshillit mund të përcaktohet grumbullimi i vetëkontributit të qytetarëve në pajtueshmëri me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë;
- p) kryen edhe detyra tjera të cilat mund të jenë të bartura nga Kuvendi i Komunës ose Kryetari i Komunës, në pajtim me ligjin dhe Statutin e Komunës.

9.2. Kryetari dhe anëtarët tjerë të këshillit aktivitetin e tyre e zhvillojnë në baza vullnetare-pa kompensim të ardhurash personale dhe në pajtueshmëri me këtë Rregullore.

Neni 10

Përgjegjësite e bartura nga komuna në Këshill

10.1. Me kërkesën e Këshillit dhe rekomandimin e Kryetarit të Komunës apo ndonjë komiteti të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar Këshillat e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

10.2. Komuna ofron burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet apo lagjet urbane, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartur.

Neni 11

Bashkëpunimi i organeve të Administratës Komunale me këshilla

Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, komitetet dhe drejtoritë e Administratës Komunale, koordinojnë punët me këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane përmes kryetarëve të këshillave, varësisht nga specifika që do të trajtohen.

12

Bashkëpunimi i këshillave lokale

Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Kaçanikut, me pelqimin e tyre mund të organizohen dhe bashkëpunojnë në mes veti për ushtrimin e aktiviteteve të përbashkëta të bartura nga komuna. Vendimin për bashkëpunimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane e miraton Kuvendi i Komunës në bazë të kërkesës së fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

Neni 13

Financimi i Aktiviteteve

- Nga vet banoret e fshatit
- Nga Komuna
- Donatorët
- Financimi i Përbashkët

14

Mospërmbushja e përgjegjësisë

Për të gjitha punët e bartura nga Kuvendi i Komunës në Këshillin e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane përkatëse, Këshilli mban përgjegjësi ligjore në rast të keqpërdorimit eventual. Përgjësia mund të jetë individuale apo kolektive para qytetarëve dhe organeve përkatëse.

Neni 15

Konflikti i dispozitave

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës, mbizotrojnë dispozitat e ligjit .

Neni 16

Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale të kësaj Rregulloreje bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së kësaj Rregulloreje.

Neni 16

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

Shtojca I

LISTA E KËSHILLAVE TË QENDRES URBANE, DHE FSHATRAVE ,
VENDBANIMEVE - NË TERRITORIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT.

N/R	KËSHILLI I QENDRES URBANE NË QYTET
1	Këshilli i Qendrës Urbane në Kaçanik; 9 anëtarë .
N/R	KËSHILLAT E FSHATRAVE -VENDBANIMEVE
1	Këshilli i fshatit Bajnicë; 5 anëtarë
2	Këshilli i fshatit Begracë; 7 anëtarë
3	Këshilli i fshatit Biqecë; 7 anëtarë
4	Këshilli i fshatit Bob; 7 anëtarë
5	Këshilli i fshatit Doganaj; 7 anëtarë
6	Këshilli i fshatit Dernagllavë; 5 anëtarë
7	Këshilli i fshatit Dubravë; 7 anëtarë
8	Këshilli i fshatit Duraj; 5 anëtarë
9	Këshilli i fshatit Elezaj; 5 anëtarë
10	Këshilli i fshatit Gabricë; 5 anëtarë
11	Këshilli i fshatit Gajre; 5 anëtarë
12	Këshilli i fshatit Gerlicë Epërme; 5 anëtarë
13	Këshilli i fshatit Gjurgjedell; 5 anëtarë
14	Këshilli i fshatit Glloboqicë; 7 anëtarë
15	Këshilli i fshatit Ivajë; 5 anëtarë
16	Këshilli i Qendrës Urbane- Kaçanik; 9 anëtarë
17	Këshilli i fshatit Kaçanik i Vjetër; 7 anëtarë
18	Këshilli i fshatit Korbliq; 5 anëtarë
19	Këshilli i fshatit Kotlinë; 5 anëtarë
20	Këshilli i fshatit Kovaçec; 7 anëtarë
21	Këshilli i fshatit Llanishtë; 5 anëtarë
22	Këshilli i fshatit Nikaj; 5 anëtarë
23	Këshilli i fshatit Nikoc; - anëtarë

24	Këshilli i fshatit Rekë; 5 anëtarë
25	Këshilli i fshatit Runjevë; 5 anëtarë
26	Këshilli i fshatit Semajë; 5 anëtarë
27	Këshilli i fshatit Sllatinë; 5 anëtarë
28	Këshilli i fshatit Soponicë; 5 anëtarë
29	Këshilli i fshatit Stagovë; 5 anëtarë
30	Këshilli i fshatit Strazhë; 5 anëtarë
31	Këshilli i fshatit Vatë; 5 anëtarë
32	Vendbanimi urban është qyteti i Kaçanikut